

**Dr. Musli Vërbani**

# **FIKHU I AGJËRIMIT**

**Kaçanik, 2016**

**Planprogrami i muslimanit të vogël**

*Autor:*

**Dr. Musli VËRBANI**

## **FIKHU I AGJËRIMIT**

*Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi*

## DUA QË MUSLIMANI TË JETË:

|     |                                     |     |                                                     |
|-----|-------------------------------------|-----|-----------------------------------------------------|
| 1.  | <b>A</b> tdhetar                    | 19. | <b>N</b> dihmëtar i të varfërve                     |
| 2.  | <b>B</b> esimtar i singertë         | 20. | <b>N</b> jerëzor dhe Humanitar                      |
| 3.  | <b>C</b> ilësor                     | 21. | <b>O</b> bjektiv                                    |
| 4.  | <b>Ç</b> lirimtar                   | 22. | i <b>P</b> a thyeshëm si shkëmb                     |
| 5.  | i <b>D</b> ashur për të gjithë      | 23. | i <b>Q</b> ëndrueshëm si Feniksi                    |
| 6.  | i <b>Dh</b> imbshëm për çdo kënd    | 24. | <b>R</b> evolucionar                                |
| 7.  | <b>E</b> dukues i shoqërisë         | 25. | <b>R</b> regullues i marrëdhënieve shoqërore        |
| 8.  | i <b>Ë</b> mbël në biseda           | 26. | <b>S</b> imbol dhe sypatrembur                      |
| 9.  | <b>F</b> alënderues i Allahut       | 27. | <b>Sh</b> ëmbëlltyrë për të tjerët                  |
| 10. | i <b>G</b> ëzuar dhe i lumtur       | 28. | <b>T</b> ejpamës i problemeve                       |
| 11. | <b>Gj</b> enerator i të mirave      | 29. | i <b>Th</b> jesht dhe modest                        |
| 12. | <b>H</b> ero në beteja              | 30. | <b>U</b> dhërrëfyes për në rrugën e drejtë          |
| 13. | Ideator i zgjedhjes së problemeve   | 31. | <b>V</b> ullnetmirë i shoqërisë                     |
| 14. | <b>J</b> etik i veprave të mira     | 32. | <b>X</b> ixëllonjë i shpresave                      |
| 15. | <b>K</b> reator                     | 33. | <b>Xh</b> evahir                                    |
| 16. | i <b>L</b> umtur                    | 34. | <b>Y</b> ll                                         |
| 17. | <b>Ll</b> ogaritar i veprave të tij | 35. | <b>Z</b> emërbutë                                   |
| 18. | <b>M</b> ënjanues i të këqijave     | 36. | <b>Zh</b> dukës i të keqes dhe zhvillues i të mirës |

**Lutju Zotit dhe thuaj: “O Zoti im  
shtoma diturinë.”**

Kur'an

***“O Zoti im më pajis me dituri të dobishme, më jep  
furnizim të begatshëm,  
mi prano veprat e mia.”***

Hadith

( شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُوا الْعِلْمِ قَانِمًا بِأَلْفِ سَبْعِينَ مِائَةً أَلْفًا مِائَةً )  
لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ .

**“Allahu dëshmoi dhe vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij Fuqplotit e të Urtit”. (Ali Imran, 18)**

( لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ  
بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ ) .

**“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët”. (Et-Tevbe : 128)**

## Hyrje

Nga Umeri radijallahu anhu, transmetohet se ka thënë:

“Një ditë ishim duke ndenjur te i Dërguari i Allahut s.a.v.s., kur u duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zeza. Në të nuk hetoheshin shenjat e udhëtimit dhe askush prej nesh nuk e njohëm. U ul pranë të Dërguarit, s.a.v.s. duke i mbështetur gjunjët e vet mbi gjunjët e tij, i vendosi duart e veta mbi kofshën e tij dhe pyeti:

O Muhamed, më trego ç’është Islami? Muhamedi a.s. iu përgjigj:

***Islami është: - të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Zotit,***

- ***të falësh namazin,***
- ***ta japësh zekatin,***
- ***ta agjërosh ramazanin,***
- ***ta kryesh haxhin në Kabe, nëse ke mundësi.***

Ai pohoi: ***Të vërtetën e the.*** Ne u çuditëm! Po e pyet dhe po ia vërteton. Pastaj pyeti: Më trego çka është Imani? Muhamedi a.s. iu përgjigj: - ***Imani është të besosh Zotin,***

- ***Melekët e Tij,***
- ***Librat e Tij,***
- ***Të dërguarit e Tij,***
- ***Ditën e fundit,***
- ***Të besosh në të caktuarit e Tij, të mirës dhe të keqes.*** Ai pastaj

tha: ***Të vërtetën e the.***

- Më trego ç’është Ihsani-Mirësia?
- Muhamedi a.s. iu përgjigj:
- ***Ta adhurosh Zotin sikur e sheh Atë, sepse, edhe pse ti nuk e***

***sheh Atë, Ai vërtetë të sheh ty.*** Pastaj pyeti: Ç’është çasti i Kijametit?

Muhamedi a.s. iu përgjigj: ***Për këtë i pyeturi nuk di më shumë se ai i cili pyet.*** Më trego mbi shenjat e tij. Muhamedi a.s. iu përgjigj:

- ***Kur robëresha t’i lind vetes zonjushë.***
- ***Kur të shihen barinjtë këmbëzbathur, të zhveshur e të mjerë se***

***si garojnë në ndërtimin e godinave të mëdha.*** Pastaj shkoi kurse unë mbeta i habitur, e Muhamedi a.s. tha: - ***O Umer a e njohe atë që më pyeti.*** Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri - iu përgjigja.

Muhamedi a.s. tha: ***Vërtet ky ishte Xhibrili, erdhi tua mësojë fenë tuaj.***” (MUSLIMI)

# **KAPITULLI I PARË**

## AGJËRIMI

Agjërim d.m.th. **me u pengua**, apo me ndalua veten nga diçka. Ndërsa, në Sheriatin Islam:

**Agjërim është me e pengu ose me e ndalu veten nga ushqimi, pija dhe epshi prej agimit e deri në perëndim të diellit, me nijet për me iu afrua Allahut xh.sh.**

Ibadeti ndaj Allahut xh.sh. bëhet në mënyra të ndryshme:

- Kemi ibadet vetëm me fjalë, siç është shehadeti;
- Ibadet me fjalë dhe me trup së bashku siç është namazi;
- Kemi ibadet me të holla, siç është zekati;
- Kemi ibadet me të holla dhe me trup, siç është haxhi.

Ndërsa agjërimi është ibadet **trupor**.

Edhe popujt e mëparshëm kanë agjëruar, mirëpo agjërimi i tyre ka ndryshua nga agjërimi në Islam. Kur'ani fisnik përmend agjërimin e Merjemes para se t'i lind djali Isa a.s., por agjërimi i saj ka qenë vetëm pengimi apo detyrimi i vetes së saj për të mos folur.

Në të njëjtën mënyrë ka agjërua edhe Zekerija a.s., kur i ka lind djali Jahja a.s. Ai tri ditë e tri net ka ngrënë dhe ka pi, mirëpo nuk ka folur. Ai vetëm ka sinjalizua me shenja. Për këtë Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

**“O ju të cilët keni besuar, ua kemi bërë obligim agjërimin ashtu siq ua kemi bërë për obligim popujve para jush, me qëllim që të jeni të devotshëm”. (El-Bekare:183)**

**Pyetje:**

1. *Trego definicionin e agjërimit?*
2. *Trego për mënyrat e ibadetit?*



## AGJËRIMI I MUAJIT RAMAZAN

Agjërimi i muajit ramazan është shtylla e katërt e islamit. Agjërimi i muajit ramazan është bërë obligim në muajin Shaban të vitit të dytë të hixhretit.

Muhamedi a.s. për 9 vite i ka agjëruar nëntë muaj të ramazanit.

Argument për agjërimin e muajit të ramazan kemi ajetin kur'anor:

**“Muaji i Ramazanit është (muaji) në të cilin filloi zbritja e Kur'anit, që është udhërrëfyes për njerëzit dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga e pavërteta). E kush prej jush përjeton këtë muaj le të agjërojë”.** (El-Bekare:185)

Argument për agjërimin e muajit ramazan kemi edhe hadithin e Muhamedit a.s. ku thotë:

**“Kush e agjëron muajin ramazan me bindje dhe sinqeritet të plotë, me shpresë se do të shpërblehet, atij i falen gabimet e mëparshme”.** (Transmeton Ahmedi)

Kush me qëllim nuk e agjëron muajin ramazan, ai do të ndëshkohet me ndëshkim të madh.

### Pyetje:

1. *Në cilin vit është bërë obligim agjërimi i muajit ramazan?*
2. *Sa vite ka agjëruar Muhamedi a.s.?*
3. *Cili është argumenti Kur'anor për agjërimin e muajit ramazan?*
4. *Cili është argumenti i hadithit për agjërimin e muajit ramazan?*

## HËNA E RE DHE RAMAZANI

### Kemi dy lloje të Kalendarëve:

1. Kalandari diellor dhe
2. Kalandari hënor.

Kalandari diellor bazohet në rrotullimin e tokës rreth diellit. Kalandari hënor bazohet në rrotullimin e hënës rreth tokës dhe së bashku me tokën rreth diellit.

**Një rrotullim i hënës rreth tokës quhet muaj. Ndërsa 12 rrotullime të hënës rreth tokës plotësohet një rrotullim i hënës rreth diellit.**

Në kalendarin hënor ndonjëherë muaji i ka 29 ditë, ndonjëherë 30 ditë. Për këtë arsye nevojitet që të pritet që të shikohet hëna e re, që të vërtetohet se muaji Shaban a i ka plotësuar 29 ditë apo 30 ditë.

Muhamedi a.s. në hadith thotë:

***“Filloni që të agjëroni me të shikuarit e hënës së re dhe ndërpritni agjërimin me të shikuarit e hënës së re”.***

### Pyetje:

1. Sa lloje të kalendarëve i kemi?
3. Në çka bazohet kalandari diellor?
4. Në çka bazohet kalandari hënor?
5. Sa ditë i ka muaji ramazan?
6. Kur fillon dita e agjërimit të muajit ramazan dhe trego hadithin?

## DOBITË PREJ AGJËRIMIT

Muhamedi a.s. në hadith thotë:

***“Agjëroni do të jeni të shëndoshë”.***

Prej agjërimit kemi dobi të shumta. Dobitë e agjërimit kryesisht janë:

- Dobi trupore;
- Dobi shpirtërore;
- Dobi mendore dhe
- Dobi shoqërore.

Agjërimi është bërë obligim që besimtari të arrijë shkallën më të lartë të besimit dhe të devotshmërisë. Për këtë arsye Allahu xh.sh. na ka tregua nëpërmjet Muhamedit a.s. se :

***“Çdo vepër e njerëzve apo e bijve të Ademit është për ta, përveç agjërimit, ai bëhet për Mua (Allahun) dhe Unë shpërblej për të. Agjërimi është mburojë” (Transmeton Buhariu)***

Muhamedi a.s. në një hadith tjetër thotë:

***“Vërtetë në xhenet është një derë që quhet “REJAN” nëpër të hynë vetëm agjëruetit ditën e Gjykimit e askush tjetër, e kur të hynë agjëruetit mbyllet ajo derë dhe askush nuk mundet të hyjë nëpër të”. (Transmeton Buhariu)***

### Pyetje:

1. Cilat janë dobitë e agjërimit?

# LLOJET E AGJËRIMIT

**Llojet e agjërit janë:**

**1. Agjërimi farz** – është agjërimi i muajit ramazan.

**2. Agjërimi vaxhib.**

Në agjërimin vaxhib bënë pjesë: Agjërimi i përbetimit, agjërimi i ditës së prishur të agjërit nafile dhe agjërimi i përbetimit të iëtikafit.

**3. Agjërimi sunet.**

Në agjërimin Sunet bënë pjesë: Agjërimi i ditës së nëntë, dhjetë dhe të njëmbëdhjetë të muajit muharrem.

**4. Agjërimi mendub.**

Në agjërimin mendub bënë pjesë:

- Agjërimi i ditëve të bardha, d.m.th. dita e 13, 14 dhe 15 të çdo muaji të muajve të kalendarit hënor.

- Agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte.

- Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit sheval.

- Agjërimi i tetë ditëve të para të muajit dhul hixhe, d.m.th. para ditës së arafatit.

- Tërë jetën me kalua një ditë në agjërim një ditë pa agjërim.

- Agjërimi i muajit sha'ban.

**5. Agjërimi mekruh tahrimen:**

Mekruh tahrimen është me i agjërua këto ditë:

- Agjërimi i ditës së parë të fitër bajramit.

- Agjërimi i ditës së parë të kurban bajramit.

- Agjërimi i ditës së premte pa ia bashkangjitur të enjten.

- Agjërimi i ditës së premte pa ia bashkangjitur të shtunën.

- Agjërimi i dy, tri e më shumë ditëve pa iftar dhe pa suhur, që d.m.th. 48 orë apo 94 orë pa ngrënë ose pa pi, ndryshe kjo quhet grevë urie.

- Agjërimi i tërë jetës pa ndërprerje.

- Agjërimi nafile i gruas pa lejen e burrit kur ai është në prani të saj.

- Agjërimi në udhëtim nëse udhëtimi është i vështirë dhe e mundon shumë gjendjen e agjëruarit.

## **6. Agjërimi mekruhi tenzihen.**

- Mekruhi tenzihen është me agjërua ditën e dhjetë të muajit Muharrem pa të nëntën.

- Mekruhi tenzihen është edhe me e agjërua ditën e dhjetë të muajit Muharrem pa të njëmbëdhjetën.

## **Pyetje:**

1. Cilat janë llojet e agjërimit?
2. Kur është agjërimi farz?
3. Kur është agjërimi sunet?
4. Kur është agjërimi mendub?
5. Kur është agjërimi mekruhi tahrime e kur tenzihen?

## RUKNET E AGJËRIMIT

**Rukni dhe sharti janë dy pjesë thelbësore të çdo çështjeje, ashtu qysh janë pjesë thelbësore të agjërimit.**

Dallimi në mes të ruknit dhe shartit është vetëm dallimi formal, sepse pa marrë parasysh a mungon rukni apo sharti agjërimit është i pavlefshëm. Mirëpo rukni është pjesë brenda agjërimit sikurse është sexhdeja pjesë përbërëse brenda namazit.

Po ashtu sharti është pjesë përbërëse jashtë agjërimit ashtu siç është abdesti është shart, jashtë namazit.

Agjërimit ka vetëm një rukn e ai është:

**“Me pengua ose me ndalua veten nga të ngrënit, pija dhe kontakti martesor, prej agimit e deri në perëndim të diellit”.**

Argument për këtë kemi ajetin Kur'anor:

**“Dhe hani e pini deri sa ta dalloni ju saktësisht perin e zi nga peri i bardhë”. (El Bekare : 187)**

- Alegoria e Kur'anit “peri i bardhë” ka të bëjë me të zbardhurit e ditës në agim.

- Alegoria e Kur'anit “peri i zi” ka të bëjë me të errësuarit e natës pas perëndimit.

Këtë e ka sqaruar Muhamedi a.s. në hadith:

***“Vërtetë Bilalli e thirr ezanin në mbrëmje ndërsa ju hani dhe pini deri sa të thirr (Bilalli) i biri i Umi Mektumit”.***

- Janë pajtua të gjithë dijetarët-juristët islam se të penguarit apo të detyruarit e vetes nga ushqimi, pija dhe kontakti martesor është prej agimit deri pas perëndimit.

### Pyetje:

1. Çka është rukni dhe çka është sharti?
2. Sa rukne i ka agjërimit?
3. Prej cilës pjesë të ditës fillon të agjëruarit dhe në cilën pjesë të ditës përfundon të agjëruarit?

## SHARTET E AGJËRIMIT

**Shartet e agjërimit ndahen në tri lloje, e ato janë:**

1. Shartet e vuxhubit (obligueshmërisë);
2. Shartet e edait (e kryerjes së agjërimit) dhe
3. Shartet e sihatit (vlefshmërisë).

**Shartet e vuxhubit (obligueshmërisë) janë:**

1. Islami;
- Jomuslimani nuk e ka për obligim agjërimin,
2. Mentalisht me qenë i shëndoshë;
3. Mosha madhore;
4. Me e ditë se e ka për obligim agjërimin.

**Shartet e edait (e kryerjes së agjërimit) janë:**

1. Shëndeti;
2. Mos me qenë në udhëtim;
- Ai i cili gjatë muajit të ramazanit është në udhëtim nuk agjëron, por të njëjtat ditë i plotëson më vonë.

**Shartet e Sihatit (vlefshmërisë) janë:**

1. Që femra mos me qenë në kohën e menstruacionit;
- nëse femrës një orë para iftarit i vjen menstruacioni atë ditë e agjëron kaza.;
2. Nijeti;
- Nijet d.m.th. qëllim. Vendi i nijetit është zemra. Kur në mbrëmje me zemër e di se nesër nevojitet me agjërua, kjo konsiderohet nijet.
- Nijeti bëhet pa aguar dita, por mund të bëhet deri para dreke.

**Pyetje:**

1. Si ndahen shartet e agjërimit?
2. Cilat janë shartet e obligueshmërisë?
3. Cilat janë shartet e kryerjes së agjërimit?
4. Cilat janë shartet e vlefshmërisë së agjërimit?

## SUNETET E AGJËRIMIT

***Sunetet apo mustehabet e agjërimit janë:***

1. Të ngriturit në Suhur. Muhamedi a.s. ka thënë: ***“Ngrihuni nga gjumi dhe ushqehuni në suhur, se në suhur e keni bekimin dhe bereketin e Allahut”***. (Buhariu dhe Muslimi)

2. Shpejtimi i iftarit. Muhamedi a.s. ka thënë: ***“E mira e njerëzve është gjithmonë kur ata e shpejtojnë iftarin”***. (Buhariu dhe Muslimi)

Nëse është mjegull, atëherë më mirë është me e vonua pak iftarin nga koha e caktuar.

3. Me fillua iftarin me hurme. Muhamedi a.s. ka thënë: ***“Kur ndonjëri prej jush e fillon iftarin le të fillojë me hurme, sepse në të ka bereket, e nëse nuk gjeni apo nuk keni hurme, atëherë me ujë se në të është pastërtia”***. (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)

4. Mustehab është me fillua iftarin me hurme apo ujë, e menjëherë me falë akshamin. Mirëpo nëse uria ndikon në moskoncentrimin në namaz, atëherë më mirë iftari e pastaj namazi.

5. Me bë dua para iftarit. Muhamedi a.s. ka thënë: ***“Duaja e agjëruesit para iftarit nuk kthehet prapë”***.

Transmeton Ibni Abasi se Muhamedi a.s. kur e fillonte iftarin lutej: ***“O Zoti im për ty agjëruam, me furnizimin Tënd ushqehem, na prano, vërtetë Ti je i ditur dhe dëgjon”***. (Transmeton Taberani)

6. Me bë ibadet më shumë se zakonisht, me bë të mira më shumë se zakonisht, me iu dhënë sadaka të varfërve, jetimëve dhe të gjorëve.

Transmeton Ibn Abasi se Muhamedi a.s. ka qenë njeriu më fisnik dhe më bujari, mirëpo ai më bujar se çdo herë ka qenë në Ramazan kur i vinte Xhibrili. I vinte në çdo mbrëmje të Ramazanit dhe ia mësonte Kur'anin. I dërguari i Allahut vërtetë ka qenë më bujari dhe mirësitë i bënte me shpejtësi të erërave. (Ahmedi, Buhariu dhe Muslimi)

7. Me e falë namazin e teravihëve.

8. Me e ndalë veten dhe mos me bisedua pa nevojë dhe mos me bë biseda të kota.

9. Me bë Iëtikafin.

**Pyetje: 1. Cilat janë sunetet e agjërimit?**



## TË LEJUARAT (MUBAHET) E AGJËRUESIT

### ***Për agjëruesin janë të lejuara:***

1. Me flladitë veten me ujë të ftohtë për shkak të nxehtësisë ose me u la për shkak të zhegut apo djersitjes.

2. Lejohet me u zgjua xhunub në mëngjes e pastaj me u pastrua dhe me vazhdua agjërimin.

“Transmeton Aishja r.a. se Muhamedi a.s. pas imsakut është zgjuar në mëngjes i papastër – xhunub nga kontakti martesor, pastaj është pastrua (ka marrë gusul) dhe e ka vazhdua agjërimin”.

3. Me i la dhëmbët, me kusht që mos me depërtua uji në fyt.

4. I lejohet agjëruesit me përqafua bashkëshorten e tij, me kusht mos me u frikësua se i ndodhë ejakulimi.

### **Pyetje:**

1. *Çka është e lejuar (Mubah) për agjëruesin?*

## **MEKRUHET (VEPRIMET E URRYERA) TË AGJËRIMIT**

**Gjatë agjërimit është mekruh:**

1. Me provua ushqimin pa nevojë me buzë apo me gjuhë;
2. Me përtypë diçka pa arsye;
3. Me puth ose me përqafu bashkëshorten;
4. Me agjërua dy ditë rresht pa ndërprerë. Pra, mos me ngrënë dy ditë rresht.
5. Me e mbajt pështymën në gojë, pastaj më vonë me e përbirë;
6. Me agjërua në kohën kur agjëruesi ka punë të rëndë e cila ia dobëson për së tepërmi shëndetin, sa që gati e paralizon, ose dhënia e gjakut.
7. Dëfrimi dhe loja intime me bashkëshorten e cila shpie deri te ejakulimi.
  - Nëse ndien siguri dhe nuk ndodh ejakulimi atëherë dëfrimi nuk është mekruh.

**Pyetje:**

1. *Çka është mekruh për agjëruesin?*

## **VEPRIMET QË NUK JANË MEKRUH PËR AGJËRUESIN**

**Nuk janë mekruh për agjëruesin këto gjëra:**

1. Me përqaftua ose me puthë bashkëshorten me kusht që ai me qenë i sigurt se nuk do t'i ndodhë ejakulimi;
2. Me shijua ose me kërkua ushqimin për përgatitjen e tij, nëse është e nevojshme ose e domosdoshme;
3. Me i lye pjesët e trupit me vaj ose yndyrë që kanë erë të mirë (p.sh. mjekrën, mustaqet);
4. Me dhënë gjak;
5. Me shpërla gojën dhe hundën ose me i la dhëmbët me brushë ose me misvak;
6. Me pastrua trupin, ose me e mbështjellë trupin me çarçaf për freskim.

**Pyetje:**

1. *Çka nuk është mekruh për agjëruesin?*

## PRISHJA E AGJËRIMIT

Agjërimi është ibadet i cili kërkon përkushtim gjatë gjithë kohës. Për këtë arsye ndodh që të veprohet diçka çka e prish agjërimin. Mirëpo të prishurit e agjërimit patjetër duhet të kompensohet ose me fjalë tjera të agjërohet kaza.

Për këtë arsye të prishurit e agjërimit është i ndarë në dy lloje esenciale.

- 1. Prishja e agjërimit që obligohet me agjëru kaza;**
- 2. Prishja e agjërimit që jo vetëm që obligon me agjërua kaza por me kompensua me kefare, që d.m.th. me agjërua edhe ditë tjera si ndëshkim.**

**Me fjalën kompensim në këtë rast kemi për qëllim me i agjërua edhe 60 ditë tjera apo dy muaj pa ndërprerje.**

Kjo është si masë ndëshkuese për mospërfilljen e ligjit të Allahut, respektivisht agjërimin.

Kompensimi bëhet edhe me lirim të një robi ose me ushqimin e gjashtëdhjetë të varfërve.

### **Pyetje:**

- 1. Çka duhet me veprua nëse prishet agjërimi?*
- 2. Sa lloje të prishjes së agjërimit i kemi?*

## **TË PRISHURIT E AGJËRIMIT QË OBLIGON ME AGJËRUA KAZA DHE KOMPENSIM**

Të prishurit e agjërimit që obligon me agjërua kaza dhe kompensim janë:

- 1. Me kontaktua me bashkëshorten;**
- 2. Me ngrënë ose me pi diçka pa arsyetim të shariatit islam.**

Ai i cili e prish agjërimin me qëllim dhe ai i cili me qëllim kontakton me bashkëshorten seksualisht gjatë ditës kur është agjërueshëm i agjëron 61 ditë. d.m.th. ditën që e ka prish e agjëron kaza dhe 60 ditë tjera dënim për prishjen e agjërimit.

### **Pyetje:**

*1. Cilat janë rastet e të prishurit e agjërimit që obligon me agjërua kaza dhe me kompensua?*

## TË PRISHURIT E AGJËRIMIT QË OBLIGON VETËM KAZA

**Veprimet të cilat e prishin agjërimin, por obligojnë me agjërua vetëm kaza, ditë – për ditë janë:**

1. Me gëlltitë diçka çka nuk është ushqim apo pije si p.sh. brumin e papjekur, orizin e pazier etj.;
2. Me përdor ushqim për shërim, apo barëra për shërim, me arsyetim të sheriatit islam:
3. Nëse agjëruesi kontakton me bashkëshorten në gjumë pa vetëdije të plotë:
4. Me vjellë gojën plotë:
5. Femrës me i ardhur menstruacioni para perëndimit të diellit, atëherë ajo ditë e agjërit automatikisht priset dhe e bënë kaza.
  - Mustehab është për femrën që kur të hajë gjatë ditës kur është me menstruacion me u fsheh dhe mos me e pa agjëruetit tjerë.

### **Pyetje:**

1. *Çka e prishë agjërimin?*
2. *Trego për prishjen e agjërit që obligon me agjërua kaza por edhe kompensim 60 ditë tjera?*
3. *Trego për prishjen e agjërit që obligon me agjërua vetëm kaza?*

## VEPRIMET QË NUK E PRISHIN AGJËRIMIN

### **Rastet kur nuk prishet agjërimi janë:**

1. Me ngrënë ose me pë diçka me harresë. Argument për këtë kemi hadithin e Muhamedit a.s.:

***“Agjëruesi i cili harron se është agjërueshëm, e hanë ose pinë (ujë), le ta vazhdojë agjërimin se Allahu është Ai i cili e ka ushqyer”;***

2. Nëse ejakulon farë (menij) pas ndonjë shikimi, të menduari apo duke fjetur;

3. Nëse e lyen kokën ose ndonjë pjesë të trupit me vaj ose yndyrë;

4. Nëse e shijon ushqimin për përgatitjen e tij;

5. Nëse jep gjak, se Muhamedi a.s. ka dhënë gjak në haxh gjatë agjërimit;

6. Nëse thithë tym, apo diçka joushqyese pa dëshirë, për shkak të rrethanave të domosdoshme;

7. Nëse thithë pluhur qoftë edhe pluhur i miellit, si p.sh. duke bluar miell në mulli;

8. Nëse në fyt i hyn ndonjë insekt gjatë fluturimit padëshirë;

9. Nëse zgjohet xhunub, madje edhe nëse mbetet xhunub gjatë tërë ditës;

10. Nëse i mbushen veshët me ujë gjatë larjes;

11. Nëse vjellë por jo gojën plot;

- me vjellë me qëllim gojën plot, atë ditë e agjëron kaza;

12. Nëse e gëlltitë gëlbazën;

13. Nëse përpin mbeturinën e pjesëve të ushqimit që mbetet në mes të dhëmbëve;

14. Nëse përtypë diçka që është më e vogël se kokrra e bizeles;

15. Me përdorë misvakun, ose me i larë dhëmbët me brushë;

16. Me u la, me u pastrua ose me marrë gusël;

17. Me marrë injeksion për shërim;

- Më mirë është me marrë injeksion pas iftarit.

### **Pyetje:**

1. Çka nuk e prishë agjërimin?

## **RASTET KUR LEJOHET MOSAGJËRIMI**

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

**“Ne juve asgjë nuk ju kemi bërë obligim e cila ju vështirëson dhe ju mundon”. (El-Haxh: 78)**

Feja islame është e bazuar në lehtësim e jo në vështirësim.

Zoti i Lartmadhëruar e di aftësinë dhe mundësinë e njeriut, për këtë arsye edhe në disa raste ka bërë lehtësime për muslimanin. Kështu edhe për agjërimin e ramazanit ka parapa raste kur disa individë të cilët janë në gjendje të vështirë mos me agjërua.

### **Rastet kur lejohet mosagjërimi janë:**

1. Sëmundja;
2. Shtatzënia;
3. Gruaja e cila i jep gji fëmijës;
4. Udhëtimi;
5. Gruaja me menstruacion dhe lehoni;
6. Pleqëria e rëndë;
7. Çmenduria;
8. Lufta e ashpër;
9. Presioni apo imponimi për mosagjërim;
10. Paraqitja e urisë deri në alivanosje.

### **Pyetje:**

1. *Në çka është e bazuar feja islame?*
2. *Cilat janë rastet kur lejohet mosagjërimi?*



## SËMUNDJA

Sëmundja e rëndë e cila dëmton shëndetin ose e dobëson agjëruesin shumë, është arsye e ligjshme në shariatin islam për mosagjërim. Për këtë thotë Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an:

**“Dhe kush është i sëmurë apo në udhëtim (dhe nuk mund të agjërojë), le të agjërojë po aq ditë më vonë”. (El Bekare: 185)**

- Me agjërua i sëmuri është mekruh;
- Pas kalimit të sëmundjes agjëron kaza.

## UDHËTIMI

Nëse besimtari para syfyrit niset në ndonjë udhëtim i cili është larg mbi 81 km, atëherë nuk e ka obligim agjërimin atë ditë.

Njëherit nëse në atë vend ku ka udhëtuar qëndron më pak se 15 ditë, nuk e ka për obligim me agjërua atë ditë.

Për këtë argument kemi ajetin Kur'anor:

**“Dhe kush është i sëmurë apo në udhëtim (dhe nuk mund të agjërojë) le të agjërojë po aq ditë më vonë”. (El Bekare: 185)**

- Pas udhëtimit, ditët e pa agjëruara agjërohen kaza.

## SHTATZËNIA

Shtatzëna ka përgjegjësi për fëmijën e porsaformuar i cili ka nevojë për ushqimin e nënës.

- Pas shtatzënisë, lehonisë dhe gjidhënies, agjëron kaza.

## GRUAJA E CILA I JEP GJI FËMIJËS

Foshnja ka nevojë për qumështin e nënës, ndërsa ushqimi i nënës është burim i qumështit. Për këtë arsye ajo është e liruar nga obligimi i agjërit. Mirëpo pasi të kalojë gjidhënia ajo ramazanin e agjëron kaza. Me fjalë tjera ditët të cilat nuk i ka agjërua i agjëron kaza.

## FEMRA ME MENSTRUACION DHE LEHONI

Nëse femrës i paraqitet menstruacioni para iftarit edhe për një çast, asaj i prishet agjërimi dhe atë ditë e kompenson mëvonë.

Kështu ajo çdo ditë të cilën nuk e agjëron e bën kaza, ndërsa namazin nuk e bën kaza.

Këtë e tregon nëna e besimtarëve – Aishja r.a. e cila tregon hadithin e Muhamedit a.s.:

*“Në kohën e të dërguarit të Allahut xh.sh. na vinin menstruacionet, andaj urdhëroheshim që ta agjërojmë kaza ramazanin, e nuk urdhëroheshim që ta bëjmë kaza namazin”.*

## PLEQËRIA E RËNDË

Plaku i cili nuk pritët të forcohet për shkak të pleqërisë së rëndë paguan FIDJEN.

Thotë Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an:

**“Ata të cilët mund të agjërojnë, por agjërimi i dobëson tej mase dhe i bënë të paafte (dhe nuk kanë shpresë të shërohen, mos të agjërojnë), le të ushqejnë një të varfër (le të paguajnë FIDJE)”.** (El Bekare: 184)

- **FIDJA – është vlerë e të hollave të çmimit të 1.666 gr. të grurit.**

Po ashtu prej agjëritit lirohet i sëmuri psikik, ai i cili detyrohet të mos agjërojë me presion të madh. Po ashtu edhe ushtria e cila është në gjendje gatishmërie të luftës apo në luftë e agjërimi mund t'i dobësojë fizikisht.

### Pyetje:

1. *Cilat janë rastet kur lejohet mosagjërimi?*

## AGJËRIMI KAZA

Të gjithë ekspertët jurist islam janë të pajtimit se ai i cili ndonjë ditë apo tërë muajin ramazan nuk e agjëron me arsye (p.sh. për shkak të sëmundjes, menstruacionit, udhëtimit) e agjëron më vonë kaza.

Argument për këtë kemi ajetin Kur'anor:

**“Dhe kush prej jush është i sëmurë ose në udhëtim (e nuk agjëron), le të agjërojë po aq ditë më vonë”.** (El Bekare:185)

Ka tregu Aishja r.a. - bashkëshortja e Muhamedit a.s. se kur ju kanë ardhur menstruacionet në kohën e Muhamedit a.s., ai i ka urdhërua me agjërua kaza më vonë.

Ndërsa ai i cili pa arsye nuk agjëron, bën gabim të madh.

Për këtë ka thënë Muhamedi a.s.:

**“Ai i cili nuk e agjëron një ditë pa arsye dhe jo për shkak të ndonjë sëmundjeje, nuk mund ta kompensojë (ta bëjë kaza) edhe nëse agjëron gjatë tërë jetës”.**

**Agjërimet kaza janë:**

1. Agjërimi i muajit ramazan;
2. Agjërimi i dënimit (kefaretit);
3. Agjërimi i zotimit;
4. Agjërimi nafile (pra e bën nijet me agjërua nafile dhe e prishë).

**Pyetje:**

1. *Cili është argumenti për agjërimin kaza?*
2. *Cilat janë llojet e agjërimin kaza?*

## KOHA E AGJËRIMIT KAZA

Nuk lejohet agjërimi kaza në ditët kur është i ndaluar agjërimi, pra në ditët e para të Bajramave.

Po ashtu nuk lejohet agjërimi kaza në muajin ramazan, sepse muaji ramazan është koha e agjëritit të rregullt, e jo koha për të agjëruar kaza. Ngase, agjërimi kaza është agjërimi i çrregullt, ndërsa nuk mundet që agjërimi i çrregullt me zënë vendin e agjëritit të rregullt.

Nëse në atë vit ramazani i ka pasur 29 ditë, atëherë vitin tjetër agjërimi i muajit ramazan kaza agjërohet 29 ditë, edhe pse muaji ramazan në vitin tjetër i ka 30 ditë.

Agjërimi i muajit ramazan mund të bëhet kaza 29 ditë rresht, pra ditë të pandara (pandërprerë), por mund të agjërohet me ndërprerje.

Pra, me rëndësi është me i plotësua ditët, ndërsa mundet me i agjërua edhe me javë të ndara.

### Pyetje:

1. *Cila është koha e agjëritit kaza?*
2. *Si bëhet agjërimi i muajit ramazan kaza?*

## KOMPENSIMI I AGJËRIMIT

Kemi tri lloje të kompensimit të agjërimit, e ato janë:

1. Lirimi i një robi.
2. Agjërimi i dy muajve rresht.
  - Nëse gjatë agjërimit të dy muajve rresht prishet një apo dy ditë, atëherë kompensimi nuk vlen, por vlen vetëm nëse fillohet prej muajit tjetër dhe me u agjërua dy muaj rresht pandërprerë.
3. Të ushqyerit e gjashtëdhjetë të varfërve.
  - Mund të ushqehet një i varfër gjashtëdhjetë ditë.

Argument për këtë kemi hadithin:

“Shkon një njeri te Muhamedi a.s. e i thotë:

- ***Jam shkatërruar o i dërguar i Allahut.***
- ***Po si je shkatërruar – e pyeti i dërguari a.s.***
- ***Kam kontaktuar me gruan ditën e ramazanit (dhe e kam prishur atë ditë).***
- ***A ke rob me lirua – i thotë Muhamedi a.s.***
- ***Jo, nuk kam.***
- ***A ke mundësi me agjërua dy muaj rresht?***
- ***Jo!***
- ***A ke mundësi me i ushqyer gjashtëdhjetë të varfër?***
- ***Jo!”***

**Pyetje:**

1. *Sa lloje të kompensimit të agjërimit i kemi?*

## FIDJE

Thotë Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an:

**“Dhe ata të cilët i mundon shumë agjërimi, mos të agjërojnë, por le t’u japin një FIDJE (le të ushqejnë) të varfrit”. (El Bekare: 184)**

- FIDJE quhet sadakaja të cilën ia jep mosagjëruesi të varfrit për shkak se nuk ka mundësi me agjërua.**

**FIDJE jepet në këto raste:**

1. Plaku ose plaka të cilët nuk mund të agjërojnë, sepse është e pamundur që ata të kthehen në rini dhe ta agjërojnë kaza.
2. I sëmuri i cili nuk ka shpresë me u shërua.
  - nuk jepet FIDJE për të sëmurin i cili ka shpresa me u shërua edhe nëse zgjatë sëmundja një kohë të gjatë.

***Pyetje:***

1. *Çka quajmë FIDJE?*
2. *Cili është argumenti për pagimin e FIDJES?*
3. *Për cilat raste jepet FIDJE?*

# IËTIKAFI

**IËTIKAF** quhet qëndrimi në xhami për ta adhurua Allahun në mënyrë të posaçme, duke qenë agjërueshëm.

IËTIKAFI është sunet kifaje muekede në dhjetë ditët e fundit të muajit ramazan.

IËTIKAFI është mustehab në ditët tjera përpos dhjetë ditëve të fundit të muajit ramazan.

## **Shartet e IËTIKAFIT janë:**

1. Me qenë musliman;
2. Me qenë i moshërritur dhe mentalisht i shëndoshë;
3. Me qenë i pastër, pra nuk lejohet për xhunubin dhe femrën kur ajo është në kohën e menstruacionit dhe lehonisë;
4. Me qenë agjërueshëm.

## **IËTIKAFI prishet në këto raste:**

1. Me bë marrëdhënie me bashkëshorten;
2. Me dalë nga xhamia pa arsytim të sheriatit islam;
3. Me u alivanosur;
4. Nëse femrës i vjen koha e menstruacionit;
5. Me ngrënë apo me pi gjatë ditës, d.m.th. nëse prishet agjërimi, atëherë prishet IËTIKAFI;
6. Me u largua nga feja;
7. Me u dehë apo me humbë vetëdijen.

## **Pyetje:**

1. Çka është IËTIKAFI?
2. Cilat janë shartet e IËTIKAFIT?
3. Çka e prishë IËTIKAFIN?



## **KAPITULLI I DYTË**

## AGJËRIMI DHE UDHËTIMI

Ishte nxehtësi e madhe, dielli përcëllonte, ndërsa rëra e shkretëtirës i përvëlonte këmbët.

Muslimanët me Muhamedin a.s. kishin marrë një rrugë të gjatë prej Medinës në Meke.

Në mes të rrugës karavani ndalet për të pushuar. Muhamedi a.s. nuk kishte kohë për të pushuar. Derisa tjerët pushonin, Muhamedi a.s. i kontrollonte dhe kujdesej për ta.

Duke i kontrolluar shokët, kur e sheh një njeri ishte shtrirë nën një hije të një lisi. Muhamedi a.s. mendoi se ishte i sëmurë dhe i pyeti shokët e tij, se çka është gjendja me të; mos është i sëmurë apo është lënduar gjatë rrugës?! Shokët i thanë: Nuk është lënduar, por ai është agjërueshëm, ndërsa rruga dhe dielli i fortë e kanë molisur. Muhamedi a.s. tha: ***“Nuk është mirë me agjërua gjatë udhëtimit”***. (Buhariu

## AGJËRIMI MË I VLEFSHËM

Abdullahu ishte djalë i ri dhe i fuqishëm. Një ditë ai e dëgjon Muhamedin a.s. duke e këshilluar njërin prej shokëve të tij:

***“Agjëro se agjërimi ka vlerë sa që vlera e tij nuk mund të barazohet me asgjë”.***

Prej këtij momenti Abdullahi filloi të agjëronte për çdo ditë pandërprerë. Kur dëgjoji Muhamedi a.s. shkoi dhe i tha:

***“Mjafton që ti të agjërosh për çdo muaj nga tri ditë”***, sepse çdo punë e mirë shpërblehet me dhjetë punë të mira dhe kjo është sikur me agjërua tërë kohën (tërë vitin).

Mirëpo Abdullahu dëshironte të agjërojë vullnetarisht më shumë se tri ditë të çdo muaji. Atëherë Muhamedi a.s. i tha:

***“Agjëro një ditë dhe mos agjëro ditën tjetër”.***

Abdullahi i tha Muhamedit a.s.: O i dërguar i Allahut, unë kam mundësi edhe më shumë të agjëroj.

***Ndërsa Muhamedi a.s. i tha:***

***“Agjëro agjërimin e Davudit a.s. dhe mos shto më shumë”.***

Abdullahu e pyeti: Po, cili ka qenë agjërimi i Davudit a.s.?” Muhamedi a.s. u përgjigj:

***“E agjëronte një ditë dhe nuk agjëronte ditën tjetër. Dhe ky lloj agjërimi është agjërimi më i merituari dhe më i vlefshmi”.***

Mirëpo Abdullahi i tha se unë mundë të agjëroj më shumë. Ndërsa Muhamedi a.s. i tha:

***“Nuk ka agjërim më të vlefshëm se ky (agjërimi i Davudit a.s.). (Mutefikun alejhi)***

## LEHTËSIMI I AGJËRIMIT

Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë obligim agjërimin e ramazanit në muajin Shaban të vitit të dytë të hixhretit.

Koha e agjërimit ka qenë prej ezanit të jacisë deri në ezanin e akshamit, ndërsa koha për iftar ka qenë prej akshamit deri në jaci. Nëse ndonjërin e zinte gjumi, prej para akshamit deri pas jacisë, ai detyrohet me e vazhdua agjërimin e ditës tjetër pa iftar e pa suhur.

Njëri prej Ensarëve (Shokëve të Muhamedit a.s.) ishte agjërueshëm. Kur pa perëndua dielli shkon në shtëpi për të bërë iftar, mirëpo në shtëpi nuk kishte asgjë të gatshme. Ishte i lodhur shumë nga puna dhe bie për të fjetur.

Derisa bashkëshortja e tij e përgatitë një ushqim, e zgjon nga gjumi për të ngrënë. Dhe para se me fillua e dëgjon ezanin e jacisë, kështu që nuk han bukë, por pa bërë iftar e vazhdon agjërimin e ditës tjetër.

Aty kah mesi i ditës, deri sa ai punonte alivanoset nga uria e tepërt. Për këtë rast i tregojnë Muhamedit a.s. dhe zbret ajeti Kur'anor:

**“Dhe hani e pini derisa ta dalloni perin e bardhë nga peri i zi (deri para sabahut), pastaj plotësojeni agjërimin deri në mbrëmje”.** (El-Bekare: 187)

Zbritja e këtij ajeti është mëshirë për muslimanët, sepse Zoti është i mëshirshëm ndaj robërve të Tij. Ndërsa ne duhet ta falënderojmë gjithnjë dhe pandërprerë, për të mirat që na i ka dhënë.

## ZBRITJA E KUR'ANIT DHE RAMAZANI

Në Meke jetonte një fëmijë i mençur, i butë dhe i sjellshëm. Ai ishte jetim. Në fillim përkujdesjen e tij e merr gjyshi i tij – Abdul Mutalibi, por, pasi që ai vdes, atëherë përkujdesjen ndaj tij e merr axha i tij – Ebu Talibi.

Ky fëmijë u rrit, u zhvillua dhe filloi të mendojë për natyrën, vendin dhe njerëzit të cilët ishin rreth tij.

Ai i shihte se ata adhuronin idhuj prej balte, prej guri e prej druri. Idhujt i kishin vendosur në brendi të Qabës dhe iu luteshin atyre.

Ky fëmijë jetim quhej Muhamed, i cili nuk mund ta duronte këtë gjendje të popullit të tij. Mendja e tij nuk mund ta pranonte të adhurohej dielli, hëna, guri e druri, se të gjitha këto i kishte krijuar Zoti.

Ai po ashtu e shihte se si njerëzit ishin injorant, të padrejtë, të cilët nuk e nderonin jetimin, nuk i respektonin prindërit, nuk iu ndihmonin të varfërve. Kështu që ai u detyrua të kalojë në malin Thevr, në shpellën e quajtur Hira. Ashtu qëndronte me javë e me muaj të tërë.

Në natën e njëzet e shtatë të muajit ramazan apo në natën e Kadrit, Muhamedit a.s. i vjen Meleku Xhibril dhe i thotë:

**LEXO!**

Muhamedi a.s. i thotë: Nuk di të lexoj.

Xhibrili pasi e përsëritë edhe dy herë tjera, i thotë:

**“Lexo me emrin e Zotit Tënd i cili ka krijuar (çdo gjë). E ka krijuar njeriun prej një rrecke.**

**Lexo se Zoti yt është më fisniku.**

**Ai e ka mësua (njeriun) me përdorë lapsin. E ka mësuar njeriun çka nuk ka ditur”.** (El-Alek: 1-5)

Pas këtyre fjalëve Muhamedi a.s. doli nga shpella e quajtur Hira dhe në horizont e sheh Melekun i cili i thotë: O Muhamed, unë jam Xhibrili, ndërsa ti je i dërguari i Allahut.

Nga kjo natë e ramazanit, ka fillua zbritja e Kur'anit dhe ka zgjatur 23 vjet. Për këtë edhe ka zbritur sureja Lejletul Kadr e cila sure tregon vlerën dhe rëndësinë e kësaj nate.

**“Ne e kemi zbritur Kur’anin në natën e Kadrit (natën më të vlefshme dhe më të rëndësishme).**

**Po ti (o Muhamed) a e di çfarë vlere ka nata e Kadrit?**

**Nata e Kadrit është më e vlefshme dhe më e dobishme se një mijë muaj.**

**Zbresin melaqet dhe shpirti i shenjt (Meleku Xhibril) në tokë në këtë natë me lejen dhe urdhrin e Zotit për çdo çështje. Dhe përshëndesin me selam deri sa të agojë dita”. (El-Kadër: 1-5)**

Kur Aishja r.a. e ka pyetur Muhamedin a.s. – cilën dua me bë në këtë natë? Muhamedi a.s. i thotë:

***“Thuaj: O Zoti im! Ti je falës i gabimeve, e do faljen e gabimeve, mi fal gabimet e mija”.***

## BEDRI DHE RAMAZANI

Muslimanët vetëm pse kanë besua në Allahun, vetëm pse kanë thënë LA ILAHE IL LALLAH, janë torturuar, janë plaçkitur dhe në fund edhe janë dëbuar prej shtëpive dhe vendlindjes së tyre.

Shokët e Muhamedit a.s. vazhdimisht kërkonin të luftojnë, por Muhamedi a.s. i këshillonte pandërprerë, duke u thënë: Duroni!

Pastaj, kur Muhamedi a.s. migroi në Medine, atje filloi një jetë të qetë, të lumtur dhe filloi ta përhap Islamin, pasi që edhe e vendosi shtetin islam. Mirëpo kjo nuk i pëlqente pabesimtarëve dhe idhujtarëve. Për këtë arsye ishin nisur ta sulmonin Muhamedin a.s. dhe muslimanët në Medine.

Për këtë arsye zbret ajeti Kur'anor:

**“Ju është lejuar lufta atyre që po sulmohen me luftë, sepse atyre iu është bërë padrejtësi dhe janë torturuar. Dhe padyshim se Allahu për me ju ndihmua atyre ka mundësi. Ata të cilët janë dëbuar nga shtëpitë e tyre pa të drejtë vetëm e vetëm se kanë thënë Allahu është Zoti ynë”. (El Haxh: 39)**

Numri i muslimanëve ishte i vogël, ndërsa numri i idhujtarëve ishte i madh. Besimtarët kishin përgatitje të vogël luftarake, ndërsa idhujtarët kishin përgatitje të madhe luftarake. Mirëpo ishte ramazan, besimi i fortë, qëndrueshmëria e fortë, por mbi të gjitha ishte ndihma e Allahut. Allahu ju dërgoi melaqe si përforcim dhe muslimanët fituan.

Për këtë Zoti i Madhëruar thotë:

**“Dhe juve ju ka ndihmuar Allahu në Bedër, derisa ishit të dobët dhe të pafuqishëm. Frikojuni Allahut dhe bëhuni falënderues ndaj Tij”. (Ali Imran, 123)**

Në këtë vit është bërë obligim agjërimi, kur zbret ajeti Kur'anor: **“O ju të cilët keni besuar, ju kemi bërë obligim agjërimit, ashtu si ua kemi bërë obligim popujve të më hershëm, që të bëheni të devotshëm”. (El Bekare: 184)**

Pasi lufta ka përfunduar, muslimanët e fituan luftën dhe u kthyen nëpër shtëpitë e tyre.

Muhamedi a.s. thotë:

***“Jemi kthyer nga beteja (xhihadi) e vogël dhe kemi filluar betejën (xhihadin) e madhe. E ajo është beteja (xhihadi) me vetveten, beteja e cila nuk përfundon deri në fund të jetës”.***

Agjërimi është arma më e fortë për të qenë i fortë, i qëndrueshëm dhe ngadhënjimtar, pas çdo sfide apo problemi të jetës.



## **Përmbajtja:**

|                                                                            |          |
|----------------------------------------------------------------------------|----------|
| Hyrje.....                                                                 | 6        |
| <b>KAPITULLI I PARË .....</b>                                              | <b>7</b> |
| AGJËRIMI .....                                                             | 8        |
| AGJËRIMI I MUAJIT RAMAZAN .....                                            | 9        |
| HËNA E RE DHE RAMAZANI.....                                                | 10       |
| DOBITË PREJ AGJËRIMIT .....                                                | 11       |
| LLOJET E AGJËRIMIT .....                                                   | 12       |
| RUKNET E AGJËRIMIT .....                                                   | 14       |
| SHARTET E AGJËRIMIT.....                                                   | 15       |
| SUNETET E AGJËRIMIT .....                                                  | 16       |
| TË LEJUARAT (MUBAHET) E AGJËRUESIT.....                                    | 17       |
| MEKRUHET (VEPRIMET E URRYERA) TË AGJËRIMIT .....                           | 18       |
| VEPRIMET QË NUK JANË MEKRUH PËR AGJËRUESIN.....                            | 19       |
| PRISHJA E AGJËRIMIT .....                                                  | 20       |
| TË PRISHURIT E AGJËRIMIT QË OBLIGON ME AGJËRUA KAZA DHE<br>KOMPENSIM ..... | 21       |
| TË PRISHURIT E AGJËRIMIT QË OBLIGON VETËM KAZA .....                       | 22       |
| VEPRIMET QË NUK E PRISHIN AGJËRIMIN.....                                   | 23       |
| RASTET KUR LEJOHET MOSAGJËRIMI .....                                       | 24       |
| SËMUNDJA.....                                                              | 25       |
| UDHËTIMI .....                                                             | 25       |
| SHTATZËNIA .....                                                           | 25       |
| GRUAJA E CILA I JEP GJI FËMIJËS.....                                       | 26       |
| FEMRA ME MENSTRUACION DHE LEHONI.....                                      | 26       |
| PLEQËRIA E RËNDË .....                                                     | 27       |
| AGJËRIMI KAZA .....                                                        | 28       |
| KOHA E AGJËRIMIT KAZA.....                                                 | 29       |
| KOMPENSIMI I AGJËRIMIT.....                                                | 30       |
| FIDJE.....                                                                 | 31       |

|                                      |    |
|--------------------------------------|----|
| IËTIKAFI .....                       | 32 |
| <b>KAPITULLI I DYTË</b> .....        | 33 |
| AGJËRIMI DHE UDHËTIMI.....           | 34 |
| AGJËRIMI MË I VLEFSHËM .....         | 35 |
| LEHTËSIMI I AGJËRIMIT.....           | 36 |
| ZBRITJA E KUR'ANIT DHE RAMAZANI..... | 37 |
| BEDRI DHE RAMAZANI .....             | 39 |